



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15.7.2024

Nr: 81

Ora: 12:00

**VENDIM**

**PËR**

**CAKTIMIN E NUMRIT TË MONITORUESVE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR  
KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 244, datë 5.7.2024, “Për caktimin e datës së Zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë”, të nenit 19, pikat 1, shkronjat “ë” dhe “n”, e 2, dhe nenit 92/4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 5, të udhëzimit nr. 3, datë 3.11.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe rregullat për monitorimin”,

**VENDOS:**

1. Caktimin e 1 (një) monitoruesi për monitorimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 15.7.2024 Nr: 81  
Ora: 12:00



“Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”